

ANKETA E STRUKTURËS SË TË ARDHURAVE NGA PUNA

Metadata Referenciale në format ESS Standard for Quality Reports
Structure (ESQRS)

INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Paraqitja statistikore.....	2
3. Përpunimi statistikor	3
4. Manaxhimi i cilësisë	5
5. Rëndësia	6
6. Saktësia dhe besueshmëria.....	6
7. Afatet kohore dhe përpikmëria	9
8. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	9
9. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	10
10. Kostoja dhe ngarkesa	11
11. Konfidencialiteti	11
12. Comment.....	12
Aneks	12

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Tregut të Punës, Drejtoria e Statistikave Sektoriale
1.3. Personi i kontaktit	Julinda Haçkaj
1.4. Funkcioni i personit të kontaktit	Specialist në Sektorin e Statistikave të Tregut të Punës
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	jhackaj@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Paraqitja statistikore	
2.1. Përshkrimi i të dhënave	Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna (ASAP) është një studim 4-vjeçar i cili ofron të dhëna strukturore të harmonizuara në të gjithë BE-në mbi të ardhurat bruto nga puna, orët e paguara dhe ditët vjetore të pushimit të paguar, Anketa kryhet sipas Rregullores së Këshillit Europian (KE) Nr 530/1999 në lidhje me statistikën strukturore mbi fitimet dhe kostot e punës, dhe Rregulloren e Komisionit (KE) Nr. 1738/2005 për ndryshimin e Rregullores (KE) Nr. 1916/2000 në lidhje me përcaktimin dhe transmetimin e informacionit mbi strukturën e të ardhurave nga puna. Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP 2022 ofron informacion të detajuar mbi të ardhurat nga puna për orë, mujore dhe vjetore sipas karakteristikave personale të punonjësve (seksi, mosha, profesioni, kohëzgjatja e shërbimit, niveli më i lartë arsimor i arritur, etj.) dhe sipas punëdhënësit të tyre (aktiviteti ekonomik, madhësia dhe kontrolli ekonomik i ndërmarrjes). Të dhënat rajonale janë në dispozicion në nivelin NUTS1.
2.2. Sistemi i klasifikimit	Aktiviteti ekonomik është i koduar në NACE Rev. 2 ndërsa profesionet janë koduar në ISCO-08. Informacioni mbi nivelin më të lartë të arsimit dhe aftësimit të përfunduar me sukses është klasifikuar sipas ISCED2011.
2.3. Mbulimi i sektorit	Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna në Shqipëri i referohet njësive lokale që i përkasin ndërmarrjeve me të paktën 10 të punësuar, në aktivitetet ekonomike të përcaktuara nga NACE Rev. 2 seksionet B deri në S, duke përjashtuar seksionin O.
2.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	Të punësuarit janë të gjithë personat që kanë një kontratë të drejtpërdrejtë pune me ndërmarrjen ose njësinë vendore dhe marrin shpërblim mbi punën e kryer,

	pavarësisht nga lloji i punës, numri i orëve të punuara (me kohë të plotë ose të pjesshme) dhe kohëzgjatja e kontratës (fikse ose e pacaktuar). Të ardhurat mesatare vjetore bruto nga puna mbulojnë të gjitha “pagesat jo të regullta”, d.m.th. pagesa që nuk ndodhin në secilën periudhë pagese, siç janë: pagesa e muajit të 13-të ose të 14-të, shpërblime për pushime, shpërblime tremujore ose vjetore të kompanisë dhe pagesa vjetore në natyrë. Të ardhurat mesatare mujore bruto në muajin e referencës mbulojnë shpërblimin e paguara në para, para çdo zbritjeje tatimore dhe kontribute të sigurimeve shoqërore që paguhën nga fituesit e pagave dhe mbahen nga punëdhënësi, dhe kufizohen në të ardhurat bruto të cilat paguhën në secilën periudhë të pagës gjatë muajit referencë. Të ardhurat mesatare orare bruto përcaktohen si fitime bruto në muajin referencë të ndarë me numrin e orëve të paguara gjatë së njëjtës periudhë. Numri i orëve të paguara përfshin të gjitha orët normale dhe jashtë orarit të punës dhe shpërblimeve nga punëdhënësi gjatë muajit referues. Orët e pa punuara, por megjithatë të paguara, llogariten si “orë të paguara” (psh. Për pushime vjetore, pushime publike, pushim të paguar për sëmundje, trajnim profesional të paguar, pushim të veçantë të paguar, etj).
2.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore është ndërmarrja dhe punonjësit që punojnë brenda njësisë së zgjedhur.
2.6. Popullata statistikore	Popullsia e punonjësve të përfshirë në Anketën e Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP janë ata që kanë marrë të ardhura për punën e kryer gjatë muajit referues (Tetor), siç kërkohet nga Rregullorja, në ndërmarrjet dhe institucionet që i përkasin sektorit privat dhe publik me të paktën 10 punonjës në NACE Rev. 2 seksionet B në S duke përfshirë O.
2.7. Zona e referencës	Të dhënat mbulojnë të gjithë vendin në nivel kombëtar NUTS 1 .
2.8. Mbulimi në kohë	Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna është kryer për vitet 2018 dhe 2022.
2.9. Periudha bazë	Periudha baze është viti 2022
3. Përpunimi statistikor	
3.1. Burimi i të dhënave	Si burim i të dhënave për Anketën e Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP është anketa mbi ndërmarrjet. Popullsia për përzgjedhjen e njësive ekonomike në Anketën e Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP 2022 përmban 128.379 ndërmarrje nga regjistri i biznesit që kanë informacionin e njësisë vendore. Kriteret e shtresimit ishin veprimtaria ekonomike, numri i të punësuarve dhe rajoni i njësisë vendore. Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP 2022 u krye duke u bazuar në një qasje të marrjes së mostrave në dy faza. Në fazën e parë, u mor një kampion i rastësishëm i shtresuar i njësive ekonomike. Madhësia e mostrës së zgjedhur është 3.463 ndërmarrje.

	Pyetësi dhe udhëzuesi për plotësim u dërguan në zyrat e njësive ekonomike të zgjedhura. Në fazën e dytë, njësia ekonomike duhej të zgjidhte një numër të punësuarve sipas udhëzimeve në shpjegim. Në lidhje me madhësinë e ndërmarrjes Shqipëria zgjodhi të përjashtojë ndërmarrjet e vogla me më pak se dhjetë të punësuar. Gjithashtu u përjashtua seksioni O të NACE Rev.2. Kjo do të thotë që nga anketa përfshijnë vetëm njësitë ekonomike të përfshira në rregullore. Një shpërndarje e ndërmarrjeve të marra në studim jepet si më poshtë: <table border="1"> <thead> <tr> <th>Madhësia e ndërmarrjes</th><th>Pjesa e të punësuarve me pagë që do të intervistohet</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>10 - 49 të punësuar me pagë</td><td>49,1%</td></tr> <tr> <td>50 - 249 të punësuar me pagë</td><td>25,2%</td></tr> <tr> <td>250 - 499 të punësuar me pagë</td><td>20,7%</td></tr> <tr> <td>500 - 999 të punësuar me pagë</td><td>17,7%</td></tr> <tr> <td>1000+ të punësuar me pagë</td><td>17,6%</td></tr> </tbody> </table>	Madhësia e ndërmarrjes	Pjesa e të punësuarve me pagë që do të intervistohet	10 - 49 të punësuar me pagë	49,1%	50 - 249 të punësuar me pagë	25,2%	250 - 499 të punësuar me pagë	20,7%	500 - 999 të punësuar me pagë	17,7%	1000+ të punësuar me pagë	17,6%
Madhësia e ndërmarrjes	Pjesa e të punësuarve me pagë që do të intervistohet												
10 - 49 të punësuar me pagë	49,1%												
50 - 249 të punësuar me pagë	25,2%												
250 - 499 të punësuar me pagë	20,7%												
500 - 999 të punësuar me pagë	17,7%												
1000+ të punësuar me pagë	17,6%												
3.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave është çdo 4 vjet.												
3.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat u mbledhën duke përdorur metodën PAPI, “Intervistë Personale e Asistuar me Letër”. Në disa raste, pyetësi elektronik u dërgua me postë elektronike. Faza e rëndësishme në përgatitjen për mbledhjen e të dhënave është përgatitja e të gjitha materialeve të nevojshme dhe përgatitja e programit për futjen e të dhënave. U identifikuan ndërmarrjet që u intervistuan, kampioni u nda midis anketuesve; anketuesit u trajnuan. Në trajnim anketuesit moren materialet e përgatitura siç janë pyetësi, udhëzuesi për plotësimin e pyetësit, detyrat e anketuesit, lista e njësive ekonomike, letra njoftuese për ndërmarrjet. Gjithçka që raportohet nga ndërmarrjet regjistrohet në procesin e mbledhjes së të dhënave. Në rast të mungesës së qartësisë, njësia raportuese kontaktohet. Në rast mos raportimi, një letër zyrtare e nënshkruar nga titullari i institucionit i dërgohet njësisë raportuese. Anketuesit i kërkohet të sillet në mënyrë etike në rast të refuzimit nga ndërmarrjet.												
3.4. Vlefshmëria e të dhënave	Vlefshmëria e të dhënave përbëhet nga kontrolle të plotshmërisë dhe kontrolle të besueshmërisë. Kontrollat e plotshmërisë janë të nevojshme për të siguruar që të dhënat e plota janë në dispozicion. Kontrollat e besueshmërisë në të gjitha variablat janë bërë për të siguruar që të dhënat janë të arsyeshme dhe në përputhje me ndryshoret e tjera. Për më tepër, më shumë kontrolle janë bërë gjatë fazës së analizës ku të dhënat janë krahasuar me të dhënat administrative. Për sa i përket vlefshmërisë së të dhënave, procedurat e editimit të të dhënave në përgjithësi i referohen nivelit mikro. - Editimi i të dhënave në programin e futjes së të dhënave. - Kontrolli i pyetësorëve në hyrje, kontrollet e plotshmërisë, kontrollet e vlerave të vlefshme, kontrolli logjik i pyetësit. Numri i pyetësorëve që												

	vijnë duhet të jetë i barabartë me numrin e pyetësorëve të shpërndarë në prefektura. • Kontrollët individuale bëhen për rastet e refuzimit dhe pa kontakte. • Ndërmarrjet aktive të përgjigjura kontrollohen për koherencën e të dhënave të dhëna në pyetësor. • Kontrolli i disa pyetjeve përmes informacionit që mund të gjendet nga kontakti individual i ndërmarrjes. Një peshë e përshtatshme llogaritet për secilën njësi që raportoi të dhënat e saj. Kjo peshë llogaritet për arsye të ndryshme: probabiliteti i pabarabartë i përzgjedhjes, rregullimi i mos përgjigjes, ndërmarrje që rezultojnë jashtë fushëveprimit. Outlier merren në konsideratë në procedurën e peshimit.
3.5. Përpilimi i të dhënave	Procesi i përpilimit të të dhënave bëhet përmes dy procedurave: Cilësia e të dhënave Ekzistojnë disa rregulla për të analizuar cilësinë e të dhënave: - Kontrolli matematik i pyetësorit; - Kontrolli logjik i të dhënave të pyetësorit; - Krahësimi i të dhënave me regjistrin administrativ; - Analizë e devijimeve të mëdha nga mesatarja. Trajtimi i mos përgjigjes Konsiderohen të gjitha rastet e mëposhtme: - Mos kontakti; - Refuzim i plotë; - Refuzime të pjesshme (për tregues të ndryshëm). Trajtimi i mos përgjigjes kryhet duke përdorur metoda të drejtpërdrejta ose kombinime të tyre siç janë: - Të dhëna nga burimi administrativ; - Përdoren të dhëna nga ndërmarrjet që kanë kushte të ngjashme.
3.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
4. Manaxhimi i cilësisë	
4.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për Statistikat Zyrtare”, Nr. 9180, datë 05.02.2004, i ndryshuar, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve. Kontrollët e cilësisë dhe vlerësimi i të dhënave janë veprime që kryhen përgjatë tërë procesit dhe më pas analizohen nga stafi me qëllim përmirësimin e cilësisë së statistikave. Stafi ka përvojën e duhur për llogaritjen e

	indikatorëve si dhe është i përfshirë në faza të ndryshme të përpilimit, të tilla si: mbledhja e të dhënave, kontrollet fillestare, hedhja e të dhënave dhe kontrollet përfundimtare.
4.2. Vlerësimi i cilësisë	Mikrodatat e Anketës së Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP kontrollohen për plotësinë dhe krahasueshmërinë. Ata kontrollohen për çdo ndryshim të madh në të dhëna, veçanërisht për shkak të devijimeve të mëdha në indikatorët kryesorë. Në rast ndryshimesh, të dhënat nga burimet e tjera të mundshme përdoren për të konfirmuar situatën e rasteve kur hasen ndryshime të mëdha të ndonjë njësie brenda bazës së të dhënave.
5. Rëndësia	
5.1. Nevojat e përdoruesit	Rezultatet dhe të dhënat e Studimit të Strukturës së të Ardhurave nga Puna (ASAP) shpesh përdoren nga publiku i gjerë shqiptar. Studentët, qendrat kërkimore, Universitetet, sindikatat, media, ndërmarrjet private dhe institucionet e administratës publike të gjithë mund të konsiderohen si përdorues të rëndësishëm të Anketës së Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP. Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP është i vetmi burim kombëtar ku të ardhurat nga puna mund të lidhen me karakteristika të rëndësishme personale siç është niveli i arsimimit ose profesioni i të punësuarit me pagë. Kombinimi mjaft unik midis veçorive individuale nga njëra anë dhe karakteristikave të ndërmarrjes nga ana tjetër gjithashtu mund të shpjegojë përdorimin e gjerë të Anketës së Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP.
5.2. Kënaqësia e përdoruesit	Asnjë Anketë e Kënaqësisë së Përdoruesit që t'i referohet të dhënave të Anketës së Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP nuk është kryer nga INSTAT.
5.3. Plotshmëria	Janë përmbushur të gjitha kërkesat e rregullores së Këshillit Europian .
5.3.1. Plotshmëria e të dhënave - shkalla e plotshmërisë së të dhënave	Shkalla e plotësisë së të dhënave, për Anketën e Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP 2022 është 100%. Kjo llogaritje mori parasysh Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 530/1999 në lidhje me statistikat strukturore të të ardhurave dhe kostot e punës, dhe Rregulloren e Komisionit (KE) Nr 1738/2005 për ndryshimin e Rregullores (KE) Nr. 1916/2000 në lidhje me përcaktimin dhe transmetimin e informacion mbi strukturën e fitimeve.
6. Saktësia dhe besueshmëria	
6.1. Saktësia e përgjithshme	Në përgjithësi, të dhënat kontrollohen për të identifikuar ndonjë ndryshim domethënës brenda bazës së të dhënave. Kur ndodhin ndryshime, të dhënat e anketës kontrollohen me burime alternative, nëse ka. Kur nuk ka informacion nga burime alternative, INSTAT korrigjon ose konfirmon të dhënat duke përdorur email ose duke thirrur të anketuarit. Masat e marra nga INSTAT për Anketën e Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP, për të rritur shkallët e përgjigjes ose për të zvogëluar ndikimin e mosrespektimit duke i imponuar janë si më poshtë: Të dhënat grumbullohen direkt nga ndërmarrja;

	Anketuesi është i trajnuar se si të trajtojë të anketuarit e vështirë; • Për shkak të mungesës së një sistemi adresash, shpesh është e vështirë për anketuesit të gjejnë ndërmarrje. Për këtë arsye, stafi i INSTAT, përmes adresave të postës elektronike ose numrit të telefonit, kontakton personin përgjegjës për kryerjen e sondazhit dhe merr më shumë informacion mbi vendndodhjen, si dhe datën dhe kohën e takimit; • Prioritet i jepet bizneseve më të mëdha. Kur këto ndërmarrje nuk pranojnë t'i përgjigjen anketuesit, i drejtohet një kërkesë zyrtare në mënyrë të veçantë për presidentin e ndërmarrjeve dhe nënshkruhet nga drejtori i përgjithshëm i INSTAT; • Një kërkesë zyrtare u dërgohet edhe kompanive të tjera që pranojnë të përgjigjen vetëm nëse informacioni kërkohet zyrtarisht; • Ndërmarrjet janë të ftuara të kontaktojnë Zyrën e Statistikave në rast pyetjesh dhe gjithmonë janë të disponueshëm staf i kualifikuar për t'iu përgjigjur thirrjeve të ndërmarrjeve.
6.2. Gabim i kampionimit	Referuar Aneksit 1 për Koeficientët e Variacionit. Të gjitha vlerat e treguesve peshohen për të përfaqësuar tërë popullatën.
6.2.1. Gabimet në kampionim - indikatorët	Në Aneksin 1 janë paraqitur Koeficientët e Variacionit të të ardhurave mesatare mujore dhe orare bruto nga puna.
6.3. Gabim jo i kampionimit	Meqenëse Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP është një anketë, të gjitha vlerësimet e ASAP janë subjekt i gabimeve të përzgjedhjes dhe gabimeve jo të përzgjedhjes. Gabimet jo të përzgjedhjes së kampionit mund të shfaqen në çdo fazë të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të anketës. Këto përfshijnë gabime në matje, gabime në përgjigje, gabime në intervistues, gabime në përpunim, etj. Intervistuesit udhëzohen që të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të marrë intervista të ASAP me punonjësit e ndërmarrjeve të zgjedhura. Pasi të jenë bërë të gjitha përpjekjet për të përfunduar intervistat, mbetet ende një numër i vogël i mos përgjigjeve të njësive. Për më shumë shiko Aneksin 2. Plotësia e të dhënave është një nga avantazhet e një regjistri administrativ. Për rrjedhojë, për mos përgjigje, ne shfrytëzojmë informacione përmes autoriteteve të administratës tatimore.
6.3.1. Gabimi në mbulim	Mbi mbulimi ndodh kur një njësi është regjistruar në regjistrin e biznesitsi aktive, por gjatë intervistës statusi nuk është më aktiv (i mbyllur / i fjetur) ose ka ndryshuar madhësinë e ndërmarrjes (më pak se 10 të punësuar) dhe nuk janë brenda objektit të studimit.
6.3.1.1. Shkalla e mbi-mbulimit	Niveli mbi-mbulimit për Anketën e Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP 2022 është 2.5%.
6.3.1.2. Pjesa e njësive që mbulohet edhe nga	Nuk aplikohet.

anketa edhe nga burimi administrativ	
6.3.2. Gabimi në matje	Gabimet në matje mund të vijnë si rezultat i përgjigjeve nga ndërmarrjet dhe të intervistuarit. Këto gabime janë rregulluar në përputhje me llogjikën. Gabime të tjera kapen gjatë fazës së përpunimit dhe kodifikimit të të dhënave, ose në fazën e pastrimit të të dhënave. Imputimet përdoren për të rregulluar këto gabime në përputhje me llogjikën.
6.3.3. Gabimi në mos-përgjigje	Për të gjithë mospërgjigjet informacioni sigurohet nga përdorimi i burimit administrativ. Për rrjedhojë, për mos përgjigje, ne shfrytëzojmë informacionet përmes autoriteteve të administratës tatimore.
6.3.3.1. Shkalla e mos-përgjigjes së njësive	Meqenëse Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP është një anketë, të gjitha vlerësimet e ASAP janë subjekt i gabimeve të përzgjedhjes dhe gabimeve jo të përzgjedhjes. Gabimet jo të përzgjedhjes së kampionit mund të shfaqen në çdo fazë të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të anketës. Këto përfshijnë gabime në matje, gabime në përgjigje, gabime në intervistues, gabime në përpunim, etj. Intervistuesit udhëzohen që të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të marrë intervista të ASAP me punonjësit e ndërmarrjeve të zgjedhura. Pasi të jenë bërë të gjitha përpjekjet për të përfunduar intervistat, mbetet ende një numër i vogël i mos përgjigjeve të njësive. Për më shumë shiko Aneksin 2. Plotësia e të dhënave është një nga avantazhet e një regjistri administrativ. Për rrjedhojë, për mos përgjigje, ne shfrytëzojmë informacione përmes autoriteteve të administratës tatimore.
6.3.3.2. Mos-përgjigja në nivel variabli	Meqenëse Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP është një anketë, të gjitha vlerësimet e ASAP janë subjekt i gabimeve të përzgjedhjes dhe gabimeve jo të përzgjedhjes. Gabimet jo të përzgjedhjes së kampionit mund të shfaqen në çdo fazë të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të anketës. Këto përfshijnë gabime në matje, gabime në përgjigje, gabime në intervistues, gabime në përpunim, etj. Intervistuesit udhëzohen që të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të marrë intervista të ASAP me punonjësit e ndërmarrjeve të zgjedhura. Pasi të jenë bërë të gjitha përpjekjet për të përfunduar intervistat, mbetet ende një numër i vogël i mos përgjigjeve të njësive. Për më shumë shiko Aneksin 2. Plotësia e të dhënave është një nga avantazhet e një regjistri administrativ. Për rrjedhojë, për mos përgjigje, ne shfrytëzojmë informacione përmes autoriteteve të administratës tatimore.
6.3.4. Gabimi në procesim	Gabimet e përpunimit vijnë nga gabimet e kodifikimit. Kodet e profesionit (sipas ISCO-08), Niveli i Edukimit (ISCED2011) dhe kodet e veprimtarisë ekonomike (NACE Rev2) bazohen në opsionin e përshkruara në pyetësor (titulli i punës dhe përshkrimi i vendit të punës; përshkrimi i veprimtarisë ekonomike dhe emri i vendi i punës, dhe niveli më i lartë i arsimit dhe aftësimit i kryer me sukses më të ndryshueshëm). Ato kontrollohen me kujdes.
6.3.4.1. Shkalla e Imputimit	Për Anketën e Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP, shkalla e përgjigjes ishte 73,8 %. Pjesa tjetër u imputua nga të dhënat administrative të INSTAT. Në

	Aneksin 2 paraqitet shkalla e përgjigjes sipas aktivitetit ekonomik (seksione).
6.3.5. Shkalla e gabimit në modelin e parashikuar për vlerësim	Nuk aplikohet.
6.4. Rregullimi stinor	Asnjë rregullim sezonal nuk është bërë në të dhënat e Anketës së Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP.
6.5. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit të Anketës së Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP bëhen në përputhje me politikën e revizionimit statistikor dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë informacion referojuni: • Politika e revizionimit; • Politika e trajtimit të gabimeve.
6.6. Praktika e rishikimit	Nuk aplikohet
6.6.1. Rishikimi I të dhënave - madhësia mesatare	Nuk aplikohet
7. Afatet kohore dhe përpikmëria	
7.1. Afatet kohore	Vonesa kohore mes datës së dorëzimit të të dhënave tremujore dhe përfundimit të periudhës referuese është rreth 540 ditë (T + 540). Publikimi bëhet në mënyrë strikte në përputhje me datat e publikuara për Statistikat e Tregut të Punës në Kalendarin e Publikimeve në faqen zyrtare të internetit të INSTAT.
7.1.1. Publikimi i rezultateve fillestare	Të dhënat e Statistikave të Strukturës së Pagës nuk përfshijnë publikimin e rezultateve paraprake.
7.1.2. Publikimi i rezultateve finale	Rezultatet e publikimit të statistikave të strukturës së pagës publikohen në bazë të kalendarit të publikimeve, me frekuencë çdo 4 vjet.
7.2. Përpikmëria	Në fund të çdo viti, INSTAT publikon Kalendarin e publikimeve për vitin e ardhshëm.
7.2.1. Përpikmëria - shpërndarja dhe publikimi	INSTAT ishte 100% i përpiktë në kohë me të dhënat e Anketës së Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP.
8. Koherenca dhe Krahasueshmëria	
8.1. Krahasueshmëria gjeografike	Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP 2022 përputhet me standardin e vendosur në Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 530/1999 në lidhje me Statistikat Strukturore mbi të Ardhurat nga Puna dhe kostot e punës dhe me përcaktimet e indikatorëve të miratuara në Rregulloren e Komisionit 1737/2005 .

	Njësia e marrjes së mostrave në fazën e parë është ndërmarrja, por informacioni i regjistrit lejon që të lokalizohet punonjësit në rajonin në të cilin ai/ajo është i punësuar.
8.1.1. Asymmetry for mirror flow statistics - coefficient	Llogaritet nga EUROSTAT.
8.2. Krahaseshmëria kohore	Krahësohet me të dhënat e periudhës paraardhëse, nuk ka ndryshime në mbulim, përcaktime dhe metodologji. Të gjithë variablat për Anketën e Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP 2022 janë në përputhje me Rregulloret e Komisionit Europian.
8.2.1. Gjatësia e serive kohore të krahasueshme	Nuk Aplikohet
8.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	I vetmi burim i mundshëm i të dhënave me të cilat mund të krahasohen të dhënat nga Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP janë të dhënat e rregullta mujore administrative për personat e punësuar dhe pagat. Shikoni krahasimin në Aneksin 3. Për këtë qëllim janë krahasuar të dhënat mbi të ardhurat mujore bruto nga puna për në mujin Tetor 2022 nga të dy burimet. Të dhënat nga ASAP 2022 janë të bazuara nga anketa dhe ato nga burimi administrativ. Ato kanë të bëjnë me të gjithë personat e punësuar në secilin aktivitet të seksionit NACE Rev.2.
8.4. Koherenca e të dhënave me frekuenca të ndryshme mbledhjeje	Nuk aplikohet.
8.5. Koherenca - Llogaritë Kombëtare	Nuk aplikohet.
8.6. Koherenca e brendshme	Konsistenca e të dhënave është kontrolluar përpara se të finalizohen rezultatet e Anketës së Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP. Lidhjet midis variablave dhe koherencës brenda grupit të të dhënave kontrollohen gjithashtu para publikimit.
9. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	
9.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacione mbi treguesit kryesorë të llogaritura nga Anketa si: Struktura e punësimit, pagat, orët e punës, hendeuku gjinor i pagave etj. Njoftimi për shtyp publikohet në internet në faqen e internetit të INSTAT.
9.2. Publikime	Rezultatet e Anketës së Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP 2022 janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT.
9.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhënat e Strukturës së të Ardhurave mund të aksesohen tek linku Databaza

	Statistikore.
9.3.1. Tabelat me të dhëna - Konsultimet	Nuk aplikohet.
9.4. Aksesit në të dhënat mikro	Baza e të dhënave në nivelin mikro nuk publikohet për arsye konfidencialiteti. Të dhënat e agreguara janë lloji i vetëm i të dhënave që u jepet përdoruesve të jashtëm.
9.5. Të tjera	Përdoruesit mund të paraqesin kërkesa specifike për të dhëna nga sondazhi i Anketës së Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP përmes faqes së internetit të INSTAT në seksionin të dedikuar për Kontakt .
9.6. Dokumentimi i metodologjisë	Dokumentacioni metodologjik mbi Anketën e Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP 2022 është kryer në bazën e Marrëveshjes së Eurostat për zbatimin e Rregullores së Këshillit 530/1999 , Rregulloret e Komisionit 1916/2000 dhe 1738/2005
9.7. Dokumentimi i cilësisë	Spektori i Statistikave të Tregut të Punës dokumentojnë të gjithë procesin e punës dhe strukturën e procedurave të anketes për qëllime të brendshme.
9.7.1. Shkalla e plotësisë së metadata-ve	Llogaritet nga EUROSTAT.
9.7.2. Metadata - Konsultimet	Nuk aplikohet.
10. Kostoja dhe ngarkesa	Personat që punojnë për Statistikat e strukturës së pagës janë: • Total staf në Zyrat Qëndrore: 2 punonjës; • Staf i përkohshëm i INSTAT: 4 Operatorë; • Staf në zyrat Rajonale: 70 Intervistues, 15 Kontrollorë.
11. Konfidencialiteti	
11.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura nga njësitë ekonomike familjare NJEF konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr.9180, datë 5.2.2004, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrotjtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikën zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.

11.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	Në përputhje me Ligjin Nr.9180, datë 5.2.2004 , për Statistikat Zyrtare, në nivelin mikro të të dhënave, në të dhënat e Anketës së Strukturës së të Ardhurave nga Puna ASAP përjashtohen Emri/Mbiemri.
--	--

12. Comment	
-------------	--

Aneks

Aneks 1: Koeficientët e variacionit

Koeficienti i variacionit për të ardhurat mujore bruto nga puna, ASAP 2022

Përshkrimi		Mesatare	Devijimi standart	Koeficienti i variacionit
		Mean	SE	CV
Gjithsej		70.806	1.078	1,5%
Me kohë të plotë (meshkuj)		73.670	1.317	1,8%
Me kohë të plotë (femra)		68.142	1.200	1,8%
Me kohë të pjesëshme (meshkuj)		74.454	3.783	5,1%
Me kohë të pjesëshme (femra)		67.566	4.194	6,2%
Aktiviteti Ekonomik (NVE Rev.2, seksione)	B	113.194	18.713	16,5%
	C	53.648	965	1,8%
	D	85.996	6.116	7,1%
	E	51.394	1.806	3,5%
	F	56.236	1.945	3,5%
	G	61.706	1.984	3,2%
	H	75.515	4.422	5,9%
	I	48.328	1.383	2,9%
	J	118.327	4.725	4,0%
	K	161.003	24.053	14,9%
	L	84.125	9.182	10,9%
	M	93.206	6.042	6,5%
	N	74.438	4.112	5,5%
	P	77.054	1.909	2,5%
	Q	74.913	1.645	2,2%
	R	82.277	8.801	10,7%
	S	71.282	4.151	5,8%
Profesioni (ISCO-08, grupe)	1	155.502	8.068	5,2%
	2	83.291	1.172	1,4%
	3	78.192	3.289	4,2%
	4	67.350	3.518	5,2%
	5	48.507	1.018	2,1%
	6	40.639	1.667	4,1%
	7	45.668	616	1,3%
	8	47.197	791	1,7%
	9	42.354	597	1,4%
Grupmosha	< 20	56.120	8.584	15,3%
	20-29	63.381	1.164	1,8%
	30-39	73.279	971	1,3%
	40-49	76.708	2.222	2,9%
	50-59	69.307	1.710	2,5%

	≥ 60	68.821	1.666	2,4%
Rajoni (NUTS 1)	Shqipëria	70.806	1.078	1,5%
Madhësia e ndërmarrjes	10-49	57.518	915	1,6%
	50-249	72.224	1.649	2,3%
	250-499	81.521	2.407	3,0%
	500-499	88.355	7.725	8,7%
	1000	79.239	4.682	5,9%
Niveli arsimor	8/9 vjeçar	43.975	772	1,8%
	I mesëm	48.127	428	0,9%
	I lartë	91.540	1.938	2,1%

Koeficienti i varicionit për të ardhurat orare bruto nga puna, ASAP 2022

Përshkrimi		Mesatare	Devijimi standart	Koeficienti i variacionit
		Mean	SE	CV
Gjithsej		406	6,3	1,5%
Me kohë të plotë (meshkuj)		417	7,6	1,8%
Me kohë të plotë (femra)		390	7,0	1,8%
Me kohë të pjesëshme (meshkuj)		669	39,1	5,8%
Me kohë të pjesëshme (femra)		574	44,7	7,8%
Aktiviteti Ekonomik (NVE Rev.2, seksione)	B	643	105,9	16,5%
	C	300	5,6	1,9%
	D	493	35,9	7,3%
	E	289	10,5	3,6%
	F	323	11,6	3,6%
	G	343	11,1	3,2%
	H	432	25,7	5,9%
	I	264	7,7	2,9%
	J	676	27,2	4,0%
	K	938	139,5	14,9%
	L	468	55,3	11,8%
	M	547	35,1	6,4%
	N	421	23,7	5,6%
	P	469	12,1	2,6%
	Q	430	10,2	2,4%
	R	491	54,2	11,0%
	S	413	24,5	5,9%
Profesioni (ISCO-08, grupe)	1	891	46,6	5,2%
	2	490	6,9	1,4%
	3	444	18,8	4,2%
	4	382	20,1	5,3%
	5	269	5,8	2,1%
	6	224	9,7	4,3%
	7	256	3,6	1,4%
	8	264	4,7	1,8%
	9	236	3,3	1,4%
Grupmosha	< 20	317	48,1	15,2%
	20-29	362	6,8	1,9%
	30-39	421	5,8	1,4%
	40-49	439	12,8	2,9%
	50-59	398	9,8	2,5%
	≥ 60	395	9,6	2,4%
Rajoni (NUTS 1)	Shqipëria	406	6,3	1,5%

Madhësia e ndërmarrjes	10-49	324	5,3	1,6%
	50-249	412	9,5	2,3%
	250-499	470	14,0	3,0%
	500-499	518	45,1	8,7%
	1000	463	27,3	5,9%
Niveli arsimor	8/9 vjeçar	242	4,4	1,8%
	I mesëm	269	2,5	0,9%
	I lartë	531	11,2	2,1%

Aneks 2: Shkalla e përgjigjes, sipas seksioneve të NACE Rev.2, ASAP 2022

Aktiviteti Ekonomik NACE rev.2	Shkalla e përgjigjes
Gjithsej	73,8%
B	80,0%
C	81,2%
D	58,1%
E	85,7%
F	68,9%
G	72,7%
H	70,8%
I	81,6%
J	59,8%
K	47,1%
L	85,7%
M	64,5%
N	68,3%
P	71,7%
Q	79,4%
R	80,0%
S	68,9%

Aneks 3: Të ardhurat mesatare mujore bruto nga puna sipas aktivitetit ekonomik

NACE rev. 2	ASAP (B42)	Të dhënat administrative per ndermarrjet me me shume se 10 te punesuar me page (Tetor 2022)	Ndryshimi i pagës mesatare mujore nga dy burimet (ASAP-Të dhëna administrative)/ASAP
B	113.194	109.273	-3,5%
C	53.648	50.127	-6,6%
D	85.996	79.276	-7,8%
E	51.394	47.345	-7,9%
F	56.236	51.865	-7,8%
G	61.706	60.266	-2,3%
H	75.515	64.759	-14,2%
I	48.328	46.594	-3,6%
J	118.327	104.861	-11,4%

K	161.003	143.047	-11,2%
L	84.125	72.507	-13,8%
M	93.206	88.674	-4,9%
N	74.438	69.878	-6,1%
P	77.054	74.939	-2,7%
Q	74.913	72.510	-3,2%
R	82.277	75.731	-8,0%
S	71.282	68.697	-3,6%
Gjithsej	70.806	68.669	-3,0%